



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite: Leksione 2 kredite (20 orë mësimore), Seminare 2 kredite (20 orë mësimore)
Viti / Semestri : Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor, Gjuhë Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i Ut-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zhvillojë kompetencat analitike dhe kritike për të kuptuar dhe analizuar strukturat morfologjike të gjuhës angleze. Të forcojë njohuritë mbi pjesët e ligjëratës dhe funksionet e tyre në ndërtimin e fjalive të sakta dhe të pasura. Të përgatisë studentët për sfidat e mëtejshme gjuhësore në fushën akademike dhe profesionale, nëpërmjet njohjes së thelluar të morfologjisë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ndihmojë studentët të identifikojnë dhe korrigjojnë gabime të zakonshme në përdorimin e pjesëve të ligjëratës si emri, folja, mbiemri, ndajfolja dhe parafjala.
2. Të zhvillojë aftësi krahasimore për të analizuar dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet formave dhe përdorimit të tyre në anglisht dhe shqip.
3. Të inkurajojë përdorimin korrekt dhe të nuancuar të formave gramatikore në komunikim të shkruar dhe të folur, përmes ushtrimeve praktike.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë forma morfologjike dhe të kuptojnë funksionin e tyre në ndërtimin e kuptimit të fjalisë.
2. Do të zotërojnë përdorimin e saktë të kohëve të foljeve, parafjalëve dhe strukturave të tjera të rëndësishme në gjuhën angleze.
3. Do të jenë të aftë të përmirësojnë stilin dhe saktësinë e të shkruarit në anglisht, duke aplikuar njohuritë morfologjike në tekste akademike dhe profesionale.